

L I G J
Nr.7828, datë 1.6.1994

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7652, DATË 23.12.1992 “PËR
PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, në nenin 7, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Banesat, në të cilat qiramarrësi ose pjesëtarë të tjerë të familjes së tij, që banojnë me të, kanë statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist të kategorisë A, B dhe të C-së vetëm personat që kanë vuajtur mbi 20 vjet internim pa ndërprerje, sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, si dhe të invalidit të luftës, kalojnë në pronësi të tyre falas”.

Neni 2

Pas nenit 7 shtohet neni 7/a me këtë përmbajtje:

“Përfitojnë privatizimin e banesës shtetërore falas qytetarët, të cilët gjer më 31.12.1993 nuk kanë privatizuar banesat e tyre dhe që hyjnë në njërin prej kategorive të mëposhtme, sipas përcaktimit të Komisionit qendror të privatizimit të banesave shtetërore, në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal:

- a) Qytetarë që janë qiramarrës në banesa të ndërtuara për zhdukjen e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe materialet e shtëpive të dëmtuara janë përdorur për ndërtimin e banesave të reja;
- b) qytetarë me të ardhura familjare nën kufirin minimal të jetesës, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;
- c) invalidë të punës që marrin pension të përhershëm dhe që nuk kanë pjesëtarë madhorë të familjes në marrëdhënie pune;
- d) qytetarët që u janë përmytur banesat nga Hidrocentrali i Fierzës dhe janë qiramarrës në banesa shtetërore”.

Neni 3

Neni 15 ndryshohet si vijon:

“Pjesa e mbetur e kredive të dhëna qytetarëve për meremetimin e banesave private dhe për përmirësimin e kushteve të banimit, të miratuara deri më datën 30.6.1991, falen deri në masën 15.000 lekë, duke u shlyer nga buxheti i shtetit nëpërmjet Entit Kombëtar të Banësive”.

Neni 4

Pas nenit 21 shtohet neni 21/a me këtë përmbajtje:

“Banesat shtetërore, për të cilat nuk paraqitet kërkesë për njohje pronësie brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, i ndryshuar me ligjet nr.7736, datë 21.7.1993, nr.7765, datë 2.11.1993 dhe nr.7808, datë 30.3.1994 në komisionin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, mbeten në administrim të entit të banesave me detyrimin e mirëmbajtjes”.

Neni 5

Neni 26 ndryshohet si vijon:

“Mënyra e privatizimit të banesave sipas dispozitave të parashikuara në këtë ligj ka fuqi deri më 31 korrik 1994”.

Neni 6

Apartamentet e privatizuara sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, administrohen nga bashkëpronarët e tyre, kur ka bashkëpronarë, në bazë të dispozitave të neneve 82, 84 dhe 85 të Kodit Civil.

Neni 7

Veprimet për privatizimin e banesave do të kryhen nga Enti Kombëtar i Banesave dhe degët e tij në rrethe.

Neni 8

Për banesat shtetërore që janë në proces gjyqësor, afati i privatizimit rivendoset nëpërmjet gjykatës.

Neni 9

Të gjitha dispozitat ligjore e nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.864, datë 14.6.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.